

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti I përgjithshëm-** me Gjyqtaren Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh.B. nga Gjakova, sipas Aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë, PP/II.nr.1446/2017 të datës 12.02.2018 për shkak të veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhër ndëshkimor me datën **13.04.2018**, mua këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP në Gjakovë, PP/II.nr.146/2017 të datës 12.02.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**I A K U Z U A R I:**

**XH.B.**, nga i ati M. dhe e ëma H. e gjinisë G., data e lindjes...., në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën "...", me nr.personal ..., ka të kryer shkollën e fillore, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion vozitës, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë s h t ë f a j t o r :**

Sepse: Me datën 21.06.2017, rreth orës 09:45 në Gjakovë në Rr."....", saktësisht në oborrin e përbashkët të pandehurit dhe të dëmtuarës E.B., nuk i ndërmer veprimet e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes nga qeni, nga pakujdesia edhe pse s'ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që deri sa e dëmtuara E.B. ishte duke u kthyer nga puna, dhe në momentin që ka hapur derën e oborrit të shtëpisë, qeni i kishte këputur zinxhirin e sigurisë dhe ishte i lirë në oborr dhe posa e dëmtuara e hap derën e oborrit i njëjti i vërsulet duke kafshuar në dorën e djathtë nën bërryl dhe në këmben e djathtë tek kofsha (afër belit) me ç' rast i shkakton lëndime të lehta trupore të konstatuara dhe përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor të Dr.D. H. të dt.11.01.2018.

- me çka ka kryer veprën penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës

Andaj, Gjykata komfor nenit 4,41,43,46,73 dhe nenit 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, dhe nenit 495 të KPPK-ës, të akuzuarit,

**I S H Q I P T O N**

Dënim me gjobë në shumën prej **300.-(Treqind).-€**, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej

**15(Pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të ekspertizës mjekoligjore të paguaj shumën prej **20.00-Euro**, si dhe në emër paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara E. R. B. nga Gjakova, Rr....., kompensimin e dëmit mund ta realizojnë në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP/II.nr.1446/2017 të datës 12.02.2017, kundër të akuzuarit Xh.B.j nga Gjakova, për shkak të veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, me propozim që ndaj të akuzuarit ti epet urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-ës gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-ës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe ti shqiptoi ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 365 par.6 lidhur me par.1 e cila dispozitë për kryesin e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 3(tri)vite.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Raporti i oficerit policor G. L. me nr..... të dt.21.06.2017.
- Raporti i reparit të emergjencës me nr..... të dt.21.06.2017 e lëshuar nga spitali rajonal "I.G." në Gjakovë në emër të dëmtuarës E.B..
- Konstatimet të ekspertit mjeko-ligjor Dr.D. H. të dt.11.01.2018, në emër të dëmtuarës E.B., për natyrën e lëndimeve trupore që bëjnë pjesë në lëndimet e lehta trupore.
- Deklarata e të akuzuarit Xh.B. të dhënë në Stacionin policor në Gjakovë, me dt.21.06.2017 dhe në Prokurorin themelore në Gjakovë, me dt.26.12.2017.
- Deklarata e të dëmtuarës E.B. të dhënë në Stacionin policor në Gjakovë me dt.21.06.2017 dhe në Prokurorin themelore në Gjakovë, me dt.21.12.2017, si dhe shkresat tjera në lëndë.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-ës, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**P. nr.138/18 më datë 13.04.2018.**

**Sekretarja juridike,**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja,**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarit të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merre formë të prerë.